



# Aneks Nr. 2

**👤🏢 Të dhënat mbi proceset e rekrutimit të ndjekura në subjekt, pranimi në Trupën e Nivelit të Lartë Drejtues, si dhe informacionet e administruara nga kandidatët pjesëmarrës në procedurat e konkurrimit të zhvilluara nga DAP për vitin 2025**

Referuar të dhënave të administruar, për **14** procedura konkurrimit të zhvilluara nga DAP, për plotësimin e **25** pozicioneve vakante të kategorive të ndryshme në shërbimin civil, në institucionet e administratës shtetërore, në të cilat grupi i punës, i ngarkuar me urdhër të Komisionerit ka **qenë prezent** gjatë fazave të konkurrimit, rezulton se, në përfundim të këtyre procedurave janë plotësuar **19** pozicione pune, nga të cilat **2** janë plotësuar përmes fazës së I “*Lëvizje paralele*” dhe **17** pozicione plotësuar përmes fazës II “*Pranim në kategorinë ekzekutive*” ose “*Ngritje në detyrë*”.

Procedurat e konkurrimit për plotësimin e pozicioneve të punës në kategorinë ekzekutive, grupi i punës ka ndjekur **7** procedura konkurrimit të shpallura nga DAP, për plotësimin e **18** pozicioneve të kësaj kategorie. Të dhënat për secilën fazë të konkurrimit paraqiten në vijim:

Faza e I “*Lëvizje Paralele*”

- ≡ Shpallur **7** **procedura konkurrimi**, për plotësimin e pozicioneve të kategorisë ekzekutive;
- ≡ **18 pozicione** pune për t’u plotësuar;
- ≡ **3 kandidatë** të kualifikuar nga verifikimi paraprak;
- ≡ **8 kandidatë** të kualifikuar nga verifikimi pas ankimit;
- ≡ **2 fitues**, në përfundim të procesit të konkurrimit.

Faza e II “*Pranim në shërbimin civil*”

- ≡ **16 pozicione** pune për t’u plotësuar;
- ≡ **236 kandidatë** të kualifikuar nga verifikimi paraprak;
- ≡ **270 kandidatë** të kualifikuar nga verifikimi pas ankimit;
- ≡ **13 fitues** (nga të cilët **3** në listë pritje), në përfundim të procesit të konkurrimit.

Procedurat e konkurrimit për plotësimin e pozicioneve të punës në kategorinë e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues, përgjatë vitit, janë monitoruar pranë DAP, **7** procedura konkurrimit të shpallura, për plotësimin e **7** pozicioneve të kategorisë së nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues. Më poshtë paraqiten të dhënat për secilën fazë të konkurrimit:

Faza e I “*Lëvizje Paralele*”

- ≡ Shpallur **7** **procedura konkurrimi**, për plotësimin e **7 pozicioneve** të kategorisë së nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues;

Faza e II “*Ngritje në detyrë/pranim në shërbimin civil*”

- ≡ **7 pozicione** pune për t’u plotësuar përmes “*Ngritjes në detyrë/pranim në shërbimin civil*”;

- ≡ **3 kandidatë** të kualifikuar nga verifikimi paraprak;
- ≡ **3 kandidatë** të kualifikuar nga verifikimi pas ankimit;
- ≡ **0 fitues**, në fazën e “*Lëvizjes Paralele*”.

- ≡ **36 kandidatë** të kualifikuar nga verifikimi paraprak;
- ≡ **48 kandidatë** të kualifikuar nga verifikimi pas ankimit;
- ≡ **4 fitues**, në përfundim të procesit të konkurrimit.

Pranimi i drejtpërdrejtë në trupën e nivelit të lartë drejtues (tnd), në nenin 28, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar përcaktohet se, pranimi në Trupën e Nivelit të Lartë Drejtues (TND) mund të bëhet vetëm nga personat të cilët kanë përfunduar formimin e thelluar në Shkollën Shqiptare të Administratës Publike. Përzgjedhja e nëpunësve në programin e formimit të thelluar për TND, bëhet nëpërmjet një konkursi kombëtar, të organizuar nga njësia përgjegjëse, ku kanë të drejtën të marrin pjesë vetëm nëpunësit civilë të kategorisë së mesme drejtuese, si dhe çdo individ tjetër, që nuk është pjesë e shërbimit civil, por plotëson kërkesat specifike për pranimin në TND.

Më tej, në nenin 29, të ligjit të sipërcituar, përcaktohet se, pranimi në trupën e nëpunësve civile të nivelit të lartë drejtues mund të bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë, nëpërmjet një konkursi kombëtar, e cila në zbatim të pikës 2, kreu V, të vendimit 118, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së*”, i ndryshuar, mund të jetë e hapur edhe për kandidatë të tjerë, jashtë shërbimit civil, të cilët plotësojnë kërkesat specifike për pranimin në TND.

Bazuar në vendimin nr. 470, datë 31.07.2025, të Këshillit të Ministrave, “*Për hapjen e procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë në Trupën e Nivelit të Lartë Drejtues, edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil dhe për përdorimin e procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë në TND, për vitin 2025*”, Departamenti i Administratës Publike ka shpallur procedurën e pranimit të drejtpërdrejtë në TND për plotësimin përmes procedurave të konkurrimit **15** pozicione të nivelit të lartë drejtues (TND), për vitin 2025, procedurë e cila është shpallur në muajin shtator, të vitit 2025.

Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, ka publikuar shpalljen për të organizuar procesin e konkurrimit për plotësimin e **15** pozicioneve në Trupën e Nëpunësve të Nivelit të Lartë Drejtues (TND), nëpërmjet procedurës së konkurrimit kombëtar, të shpallur në shtator të vitit 2025, në përfundim të të cilit, janë arritur rezultatet si më poshtë:

- ≡ **15 pozicione** të shpallura për tu plotësuar përmes procedurave të konkurrimit;
- ≡ **55 kandidatë** të kualifikuar nga verifikimi paraprak;

- ≡ **57 kandidatë** të kualifikuar pas afatit të ankimit, (lista përfundimtare);
- ≡ **15 kandidatë** të shpallur fitues.

Nga monitorimi i procedurës së konkurrimit të shpallur në portalin e Departamentit të Administratës Publike, konstatohet se, njësia përgjegjëse ka zbatuar procedurat e përcaktuara në nenin 27, 29, 30 dhe 31, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i

ndryshuar dhe në vendimin nr. 118, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe anëtarëve të TND”, i ndryshuar, në lidhje me:

≡ publikimin e aktit të shpalljes për plotësimin e **15** pozicioneve të nivelit të lartë drejtues, duke pasqyruar në të elementët dhe të dhënat e nevojshme në lidhje me përshkrimin përgjithësues të pozicionit të punës, kriteret e përgjithshme, kërkesat specifike të pranimit, si dhe kushtet dhe kërkesat e veçanta, aftësitë, njohuritë e cilësitë, që kandidatët duhet të zotërojnë për të aplikuar në konkursin për pranim në trupën e nëpunësve të nivelit të lartë drejtues (TND);

≡ publikimin e listës paraprake ku

janë kualifikuar **55** kandidatë dhe listës përfundimtare me **57** kandidatë të kualifikuar, pas afateve të ankimimi, për të vijuar më tej me fazën e dytë të konkurrimit, vlerësimit të testimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë;

≡ publikimin e listës paraprake dhe listës përfundimtare, ku rezultojnë **15** kandidatë të shpallur fitues në përfundim të procedurës së vlerësimit me pikë, duke garantuar të drejtën e ankimit, për kandidatët të cilët nuk janë shpallur fitues.

Trajtimi i informacioneve të administruara pranë komisionerit, në kuadër të mbikëqyrjes së orientuar për verifikimin e ligjshmërisë së procedurave të konkurrimeve të zhvilluara nga DAP, për vitin 2025, të zhvilluara nga njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike për plotësimin e pozicioneve vakante në shërbimin civil, pjesë e institucioneve të administratës shtetërore, Komisioneri ka trajtuar **11** informacione/kërkesa të ardhura në adresë të tij, të dërguara nga nëpunës apo kandidatë që kanë marrë pjesë në procedurat e konkurrimit, për vitin 2025, për të cilat janë pretenduar se janë kryer apo lejuar parregullsi gjatë zhvillimit të tyre.

Për secilin informacion të administruar, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11 dhe nenin 14, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ka nisur procesin e verifikimit të informacionit, në përfundim të procesit ka rezultuar se, nuk ka konstatuar paligjshmëri gjatë aplikimit të institutit të rekrutimit në shërbimin civil, gjatë zhvillimit të këtyre procedurave të konkurrimit.

Procesi i verifikimit ka përfshirë shqyrtimin e plotë të dokumentacionit administrativ të vënë në dispozicion nga njësia përgjegjëse, analizën e praktikave të ndjekura gjatë fazave të ndryshme të konkurrimit, si dhe vlerësimin e përputhshmërisë së veprimeve procedurale me kërkesat ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, është analizuar respektimi i parimeve themelore të transparencës, barazisë në konkurrim, meritokracisë dhe paanshmërisë, të cilat përbëjnë bazën e funksionimit të sistemit të shërbimit civil. Gjithashtu, janë marrë në konsideratë edhe pretendimet konkrete të paraqitura nga palët, duke u trajtuar secili rast në mënyrë individuale dhe të paanshme.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në vlerësim të rrethanave të mësipërme, dokumentacionit të administruar në kuadër të mbikëqyrjes së orientuar, si edhe shqyrtimit të informacioneve që kanë ardhur nga palë të interesuara për administrimin e shërbimit civil, arrin në konkluzionin se, procesi i rekrutimit të nëpunësve civilë, të zhvilluar nga Departamenti i Administratës Publike, është kryer në zbatim të procedurave të përcaktuara në ligjin nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore që rregullojnë këtë aspekt të ligjit.

Komisioneri vlerëson se garantimi i një procesi rekrutimi të ligjshëm dhe transparent është thelbësor për forcimin e besimit të publikut në administratën shtetërore dhe për konsolidimin e një shërbimi civil profesional e të qëndrueshëm. Në këtë kontekst, mbikëqyrja e vazhdueshme dhe trajtimi me seriozitet i çdo informacioni apo kërkesë të paraqitur nga nëpunësit apo kandidatët mbetet një instrument i rëndësishëm për përmirësimin e vazhdueshëm të standardeve administrative dhe për parandalimin e çdo praktike që mund të çenojë integritetin e sistemit të shërbimit civil.

**Vendim përfundimi nr. 1, datë 15.01.2026**

*Departamenti i Administratës Publike*

